



Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivered	30.12.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedimica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMBHCK	3692/2022		15



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1051/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në çështjen juridike “masë disiplinore”, sipas ankesës me numër A.nr.1051/2022 të datës 23.11.2022 të parashtruar nga nëpunësi civil

duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 30.12.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa më numër A.nr.1051/2022 e datës 23.11.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. **Anulohet** masa disiplinore “Vërejtje” e shqiptuar ndaj ankuesit përmes Vendimit më numër protokoll 1327/22 të datës 20.10.2022, të Mbikëqyrësit të Lartë në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- III. **Obligohet** Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të largoj nga dosja personale e nëpunësit civil si dhe regjistri përkatës masën disiplinore të anuluar si në pikën II.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, më datë 23.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 7455/2022 në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 1327/22 të datës 20.10.2022 të Mbikëqyrësit të Lartë në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan lidhur me shqiptimin e masës disiplinore "vërejtje", për shkak të shkeljeve procedurale dhe materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 01.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Shërbimi Korrektues i Kosovës. Ndërsa, Këshilli me datë 05.12.2022 ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së ankesa është pranueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7355/2022 të datës 23.11.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokollit 1327/22 të datës 20.10.2022 të Mbikëqyrësit të Lartë në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan; Plotësimin e ankesës më datë 25.11.2022 me numër protokollit 7429/2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 7537/2022 e datës 01.12.2022; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 7663/2022 e datës 05.12.2022; Kontratën e Punës për Kohë të Pacaktuar e datës 16.07.2020 për ankuesin; Deklaratën me shkrim të ankuesit të datës 19.10.2022; Shkresë me titull: *te gjeturat gjatë vizitës nga zyrtarët e SHKK e datës 20.10.2022*; Emailin e datës 01.12.2022 nga për

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësishëm të shqyrtimit administrativ, konstatoi se është e bazuar ankesa e ankuesit, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesi është i punësuar në pozitë *Zyrtar Korrektues* në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan-Shërbimi Korrektues i Kosovës. Bazuar në shkresën të datës 20.10.2022 me titull "*te gjeturat gjatë vizitës nga zyrtarët e SHKK*", Mbikëqyrësi i Lartë në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, më datë 20.10.2022 përmes Vendimit me numër protokollit 1327/22 ka shqiptuar ndaj ankuesit masën disiplinore "Vërejtje", me arsyetimin se i njëjti ka kryer shkelje të lehta disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 4 nënparagrafi 4.2 dhe 4.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se masa disiplinore është e shqiptuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, duke theksuar se: "*Më datë 19.10.2022 jam njoftuar nga Ambulanta e Burgut që të dërgoj për trajtim mjekësor të paraburgosurin dhe për këtë e kam njoftuar mbikëqyrësin që të dërgoj një oficer tjetër nga njësia përgjegjëse për transport të të burgosurve, mirëpo në mungesë të stafit jam detyruar që vet të dërgoj të paraburgosurin në ambulante dhe kam qëndruar me të deri në marrjen e infuzionit. Pas kthimit dy zyrtarë të qendrës gjatë bisedës vërejnë mos plotësimin e raportit të mbikëqyrjes për të paraburgosurin me ç' rast i kam njoftuar së arsyeja e mosplotësimit të këtij raporti ishte qëndrimi imë në ambulante.*

Ndërsa në përgjigjen në ankesë, Këshilli vëren së mbikëqyrësi i ankuesit nuk ka dhënë përgjigje në pretendimet ankimore të ankuesit.



Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht Kolegji analizoj:

Nenin 45 më të cilin është përcaktuar se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*.

Nenin 46, i cili trajton shkeljet disiplinore ku përcakton se: *"shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta, Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mospërmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i delhur në punë". Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar", ndërsa "Shkelje të lehta konsiderohen: 4.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; 4.2. shkelja e rregullave të etikës; 4.3. sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; 4.4. kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar"*.

Nenin 47 paragrafi 1 më të cilin është përcaktuar se: *"Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjatë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil"*.

Nenin 48 i cili ka përcaktuar se: *"1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor"*.

Bazuar në kuadrin ligjor si me sipër, Kolegji ka analizuar vendimin më numër protokoll 1327/22 i datës 20.10.2022 lidhur me shqiptimin e masës disiplinore "vërejtje" dhe si rrjedhojë ka konstatuar së arsyetimi i vendimit të kundërshtuar më ankesë është i mangët dhe i pamjaftueshëm, pasi që i njëjti nuk përmban sqarim lidhur me faktet vendimtare që kanë sjell nxjerrën e vendimit gjegjësisht shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit kështu që duke u

bazuar në nenin 48 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij.

Kolegji i Këshillit bazuar në provat materiale të administruara vlerëson së Mbikëqyrësi i Lartë në cilësi të Udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, me rastin e shqiptimit të masës disiplinore të kundërshtuar me ankesë nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike, pasi që i njëjti sipas shkresës së datës 20.10.2022 nuk ka përcaktuar saktë ndërlidhjen kohore mes veprimeve të ankuesit gjegjësisht ndërlidhjen e kohës kur ankuesi duhet të plotësonte Formularin e mbikëqyrjes për të paraburgosurin me iniciale _____ me kohën derisa ankuesi ishte në ambulanten e burgut me të paraburgosurin _____ pasi që dërgimi i tij nuk ishte bërë nga njësia gjegjëse, dhe së Mbikëqyrësi i Lartë nuk ka marr parasysh faktin se ishte në dijeni së ankuesi atë ditë ishte në ambulanten e burgut. Për me tepër, nga shqyrtimi i vendimit të kundërshtuar me ankesë rrjedhë së Mbikëqyrësi i Lartë konstatimin e përgjegjësisë disiplinore të ankuesit e bazon vetëm në shkresën e datës 20.10.2022 lidhur me të gjeturat gjatë vizitës së zyrtareve të ShKK-së, ndërsa nga analizimi i provave materiale të çështjes Kolegji i Këshillit nuk ka gjetur ndonjë raport nga Njësia për Siguri e SHKK lidhur me konstatimet sikurse përcaktohen në shkresën e datës 20.10.2022 të Mbikëqyrësit të Lartë. Andaj, mbi bazën e këtyre rrethanave Kolegji konstaton si Mbikëqyrësi i Lartë ka dështuar në përcaktimin e drejtë të shkeljeve disiplinore të ankuesit, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 50 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë me të cilin shprehimisht thuhet se: *Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përpjekjet e mëparshme të nëpunësit për shmangien apo kufizimin e dëmit...”,* rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit Mbikëqyrësi i Lartë ka dështuar që të vërtetoj faktet nëse mos plotësimi i raportit të mbikëqyrjes për të paraburgosurin me inicialet _____ ishte bërë si pasojë e refuzimit apo neglizhencës së ankuesit dhe së me mos plotësimi i tij ka shkaktuar ndonjë dëm në raport me të paraburgosurin apo institucionin korrektues, kështu që bazuar në këto konstatime rrjedhë së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit.

Nisur nga gjendja faktike dhe juridike si ma sipër, Kolegji konstaton së një vendim i nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore është akt administrativ i paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nënparagrafi 13 dhe 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që siç përcaktohet në dispozitivin e këtij vendimi obligohet Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës që të largoj nga dosja personale e ankuesit masën disiplinore të shqiptuar përmes vendimit të kundërshtuar me ankesë.

Theksuar si lartë, Kolegji i Këshillit bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -*

Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1051/2022.

Ilire MEHMETI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.